



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 534/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Levizja Vetevendosje (LVV) dega ne Istog, paraqitur kundër subjektit politik Parise Demokratike te Kosoves (PDK) dega ne Istog per shkak te parregullsive gjate procesit zgjedhor ne ditën e zgjedhjeve ne qytetin e Istogut, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Levizjes Vetevendosje (LVV) dega ne Istog.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 04.11.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik LVV dega në Istog, në të cilën theksohet se me datën 03 nentor 2013, ne ora 13:37, Vendvotimi 06006C, Vrelle, personi me emrin Visar Haxhijaj, vëzhgues i certifikuar i PDK-se pergjate gjithë kohës ka qendruar ne koridorin dhe ne oborrin e qendres se votimit ne Vrellë. Ne kete menyre i njejt person ka bere presion te votuesit qe te votohet kandidati i PDK-se Shasivar Haxhijaj per kryetar te komunes se Istogut qe eshte edhe vellau i te apostrofuarit ne fjale Visar Haxhijaj vëzhgues i certifikuar i PDK-se.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 te LZP-se parashihet se: *”Mund te apelohe vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit te fakteve te reja nga pala e interesuar”.*

Pretendimet ankimore nga ana subjektit politik LVV-se, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa, janë të pabazuara, nga shkakun se nga parashtruesi e ankesës nuk është bashkangjitur asnjë provë shtese ankeses së parashtruar, me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikohesh vërtetësia e shkeljes së pretenduar.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet qe jane cekur ne ankesë, PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa e lart

përmendur u refuzua si e pa bazuar. Andaj nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 534/2013 më datën 07.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitet ankese ne Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.